



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201502191/5

Tiranë ___/___/2015

Lënda : *Rekomandojmë marrjen e masave për shpejtimin dhe gjykimin e çështjes civile me Nr.02895 akti, datë 03.09.2014 me paditës G. S. nga Tirana.*

Drejtuar : **Z.Rudin BAQLI**
Kancelar i Gjykatës së Lartë

TIRANË

I nderuar zoti Baqli,

Në ankesën e tij datë 29.10.2015 drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit, shtetasi G. S. nga Tirana ankohet për zvarritje gjykimi të padrejtë dhe pa shkaqe ligjore nga Gjykata e Lartë Tiranë, në gjykimin e një çështje civile me Nr.02895 akti, datë 03.09.2014 kundra D.R.S.SH. Tiranë me objekt detyrimin e palës paditur D.R.S.SH. Tiranë për pagimin e pensionit.

Nga verifikimet e kryera nga ana jonë rezulton se me vendimin gjyqësor me Nr.9421 datë 11.10.2012 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur Rrëzimi i padisë së tij .Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë me vendimin me Nr.266 datë 20.02.2014. Ndaj këtyre vendimeve gjyqësore ankuesi G. S. ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë Tiranë, duke kërkuar prishjen e dy vendeve gjyqësore dhe duke e gjykuar çështjen në fakt të vendoset përfundimisht pranimi i padisë së tij.

Aktulisht dosja e ankuesit ndodhet e regjistruar për gjykim në Gjykatën e Lartë Tiranë, me Nr.02895 akti, datë 03.09.2015 dhe si relatore është caktuar Zj.Arjana Fullani. A. G. S. nga ana e tij pretendon se periudhën e punës si punëtor nëntoke për rreth 21 vjet e ka të pasqyruar në librezën e tij të punës dhe se nga viti 2001 deri me 20.04.2011 ai është trajtuar me pension të veçantë si punëtor nëntoke sipas legjilacionit në fuqi.

Me mbushjen e moshës 58 vjeç, ai ka paraqitur kërkesën dhe dokumentat përkatëse në D.R.S.SH. Tiranë, për të përfituar pension të kategorisë A, ku thuhet se duhet të kesh mbi 15 vjet e 6 muaj punë si punëtor nëntoke. Ankuesi pretendon gjithashtu se vendimet gjyqësore janë të padrejtë dhe të pa bazuar në ligj dhe gjykata nuk ka marrë parasysh faktin se ankuesi G. S. disponojë librezën e tij të punës e cila është e saktë dhe në të ai ka të pasqyruar vjetërsinë e punës si punëtor nëntoke si dhe dokumenta të tjera për punën e kryer.

Ankuesi ka kërkuar nga institucioni ynë që të ndihmohet dhe të ndërhyhet për shpejtimin dhe gjykimin e kësaj çështje gjyqësore, nga Gjykata e Lartë Tiranë në bazë të parashikimeve të nenit 6/1 të KEDNJ dhe të nenit 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: "Kushdo për mbrojtjen e të drejtave të lirive dhe të interesave të tij Kushtetuese dhe ligjore ose me rastin e akuzave të ngritur kundër tij ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanëshme e caktuar me ligj".

Po kështu në zbatim të kërkesave të nenit 14 të Kodit Procedurës Civile, ku parashikohet se: "Gjykata ka për detyrë që të zhvillojë një proces të rregullt ligjor nëpërmjet garantimit të zhvillimit të një hetimi të plotë e të gjithashëm në përputhje me ligjin". Nga Gjykata ka vend që në rastin konkret të respektohen kërkesat e nenit 28 të këtij kodi, ku thuhet se: "Gjykata duhet të shprehet për të gjitha kërkesat që parashtrohen në padi, pa i kaluar kujfijtë e saj duke realizuar një gjykim të drejtë, të pavarur dhe të paanëshëm brenda një afati të arsyeshëm.

Në këto kushte, dhe bazuar në kërkesat e nenit 63/3 të Kushtetutës së RSH, ku thuhet se, Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekoamndime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike", dhe neni 21/b të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", ku thuhet se pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive.

Për sa më sipër ju,

REKOMANDOJMË:

1. Të merren masa për shpejtimin dhe gjykimin e çështjes civile me Nr.02895 akti, datë 03.09.2014 me Paditës G. S. kundra palës së paditur D.R.S.SH. Tiranë, me objekt detyrim për pagim pensioni pleqërie.

2. Mbi shqyrtimin e këtij rekomandimi dhe masat e marra nga ana juaj në bazë të nenit 22 të Ligjit me Nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", lutemi na njoftoni brenda një afati prej 30 ditësh.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Arben SHKËMBI